



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË
OSNOVNI SUD MITROVICI - BASIC COURT OF MITROVICA

P.nr.136/2014

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i përgjithshëm, me Gjyqtarin e vetëm gjykues Bekim Veliqi, procesmbajtëse Valdete Sadiku, në çështjen penale ndaj të pandehurit M.I nga ..., për veprat penale Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose shenjave nga neni 414 të KPRK-së dhe të veprës penale Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.3 të KPRK-së në bashkim real me pikën I të dispozitivit të aktakuzës, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.175/2014, dt.31.07.2014, e përfaqësuar nga Prokurori i Shtetit Ibrahim Fejza, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor e cila ishte e hapur dhe publike, në bazë të nenit 359, 360, 361, 362, 366 të KPP-së me dt.27.05.2019 është marrë dhe shpallur publikisht aktgjykimi, ndërsa aktgjykimi është përpiluar me dt.06.06.2019;

A K T G J Y K I M

I akuzuari; M.I, nga i ati Xh., e ëma S., i lindur me dt. ..., në fsh. ... Komuna e ..., me nr. personal ..., me vendbanim në rr. "..." E-... nr...., ... Komuna e ..., i martuar baba i tre fëmijëve, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE:

I. Me dt.21.03.2014, rreth orës 10:40 min. ka hequr vulën zyrtare të vendosur nga zyrtarët e autorizuar të HPD/Agjencia Kosovare e Pronës me qëllim të sigurimit të objektit-banesës e cila gjendet në rr. "..." E- ... nr. ... në ... në ... e cila vulë është vendosur me dt. ... nga AKP të cilët kanë ekzekutuar urdhrin për dëbim meqenëse kjo pronë është nën administrimin e AKP-së.

Me këtë ka kryer veprën penale Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose shenjave nga neni 414 i KPRK-së.

II. Me dt.21.03.2014, në të njëjtën kohë dhe vend si në pikën I të dispozitivit, në mënyrë të kundërligjshme ka uzurpuar pronën e paluajtshme të personit tjetër duke e ditur se prona e tillë i është nënshtruar dëbimit me urdhër të institucionit të themeluar në bazë të ligjit të zbatueshëm në Republikën e Kosovës, ashtu që ka hequr vulën zyrtare të vendosur nga zyrtarët e AKP-së, ka ndërruar çelësin në derën e banesës të cekur në pikën I të dispozitivit.

Me këtë ka kryer veprën penale Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.2 nën par.2.2 të KPRK-së, në bashkim real me veprën penale nën pikën I të dispozitivit.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 21, 41, ..., 45, 73 të KPK-sw, dhe nenit 359, 360, 361, 365, 366 të KPP-së i;

S H Q I P T O N

DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej katër (4) muajve për veprën penale Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose shenjave nga neni 414 i KPRK-së.

DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej katër (4) muajve për veprën penale Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.2 nën par.2.2 të KPRK-së.

Gjykata në mbështetje të nenit 80 par.1 lidhur me par.2 nën par.2.2 e lidhur me nenin 50, 51, 52 të KPRK-së të akuzuarit i;

S H Q I P T O N

DËNIMIN UNIK ME BURGIM në kohëzgjatje prej gjashte (6) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej një (1) viti nëse i akuzuari gjatë kohës së verifikimit nuk kryen vepër penale.

I akuzuari lirohet nga pagesa e shpenzimeve procedurale dhe të paushallit gjyqësor për shkak se pagesa do të rrezikonte gjendjen materiale të të akuzuarit.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin civilo-juridik.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Mitrovicë-Departamenti i përgjithshëm, pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Departamenti i përgjithshëm, ka parashtruar Aktakuzën PP.II.nr.175/2014, dt.31.07.2014 ndaj të pandehurit M.I., nga ..., për veprat penale Heqja e apo dëmtimi i vulave zyrtare ose shenjave nga neni 414 të KPRK-së dhe të veprës penale Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.2 nën par.2.2 të KPRK-së.

Në këtë çështje penale gjyqtari ka caktuar seancat e shqyrtimit fillestar të dt.11.05.2018 dhe dt.21.11.2018 me pas është vazhduar me seancat e shqyrtimit gjyqësor të dt.10.05.2019, 16.05.2019 dhe 27.05.2019 ku janë ndërmarrë veprimet përkatëse juridike në këtë çështje dhe po të njëjtën datë është bërë edhe shpallja publike e aktgjykimit.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor palët janë njoftuar me të drejtat ligjore në këtë çështje penale, respektivisht përfaqësuesi i palës së dëmtuar – dëshmitarët janë njoftuar në kuptim të nenit 125, 127, 129 të KPP-së po ashtu edhe të akuzuarin në kuptim të nenit 323 par.1 dhe 2 pika 2.1, 2.2 dhe 2.3 të KPP-së, ndërsa përfaqësuesi i palës së dëmtuar është njoftuar po ashtu me të drejtën e tij ligjore sipas nenit 322 par.2 të KPP-së.

Prokurori i Shtetit në seancën e shqyrtimit gjyqësor dt.27.05.2019 edhe në paraqitjen e fjalës përfundimtare ka deklaruar se mbetet pranë aktakuzës së parashtruar ndaj të pandehurit për veprat penale për të cilat akuzohet, propozoj gjykatës që të njëjtin ta shpallë fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar i cili në fjalën përfundimtare deklaron se: mbetëm tërësisht pranë shkresave të dorëzuara gjykatës duke u bazuar se Agjencia bënë inspektimin e rasteve çdo 3 muaj në rastin konkret ka konstatuar se i pandehuri jeton në kushte të dobëta materiale dhe pronën e ka shfrytëzuar vetëm për nevoja familjare që do të thotë nuk e ka keqpërdorur.

I pandehuri në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në atë kohë kam qenë shfrytëzues i asistencës sociale, jam babai i tre fëmijëve, kam qenë i pa punë, banesa ka qenë e thyer kur kam hyrë edhe në herën e parë po ashtu edhe herën e dytë, jam në shfrytëzim për shkak të pa mundësisë tjetër të zgjidhjes së çështjes së banimit dhe se kushtet aty janë të rënda, gjykata të me liroj nga akuza.

Në këtë çështje penale në cilësinë e dëshmitarit është proceduar A.A. dhe A.K., zytarë pranë Agjensionit Kosovar për krahasim dhe verifikim të pronës për regjionin e Mitrovicës, që nga i njëjti të marrim dëshminë e drejtpërdrejtë në këtë çështje penale, me qëllim të sqarimit të fakteve të rëndësishme.

Ne seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt.27.05.2019, dëshmitari A.A. ka deklaruar; në vitin 2014 kam punuar në Agjensionin Kosovar të pronës por tani ka ndryshuar emërtimi dhe quhet Agjencia Kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës, i cili ka shtuar se ne sipas detyrës zyrtare pas dëbimit shkujmë në inspektim për të verifikuar nëse prona është riuzurpuar apo jo dhe me dt. 21.03.2014 sipas raportit rreth orës 10:40 kemi qenë në inspektim dhe kemi konstatuar se pronës i është hequr vula, i është ndërruar çelësi dhe personi i njëjtë është takuar në pronë është fjala për Musli Ismajlin

dhe unë vet e kam parë personalisht është fjala për dt.21.03.2014, ne në inspektim shkojmë nga dy persona zyrtar me mua ka qenë A.K., ne pastaj e kemi raportuar për gjendjen që kemi hasur në teren me qëllim që të njëjtit të marrin veprime të tjera.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt.27.05.2019, dëshmitari A.K. ka deklaruar se kemi bërë inspektimin e pronës e cila gjendet në rrugën "... " E... nr. ... Komuna e ..., kemi konstatuar dëmtimin e vulës ndërrimin e cilindrit dhe banesa ka qenë e riuzurpuar, në atë kohë une kam qenë si fillestar, banesa ka qenë e riuzurpuar por personi nuk më kujtohet saktë dhe qëndroj pranë konstatimeve të bëra në raportin ditorë dt.21.03.2014.

Pasi që nuk ka pasur propozime të tjera, procedura ka vazhduar me leximin e provave dhe atë janë lexuar respektivisht vështruar; raporti i dëbimit për dëbim dt. 20.03.2014, raporti ditor në teren me numër të lëndës ... i dt.21.03.2014, foto dokumentacion nga shkresat e lëndës gjithsej dy faqe me konstatim dt.21.03.2014, lexohet aktvendimi me nr. të protokolit ... i dt 04.04.2014 mbi të drejtën e vazhdimit të ndihmës sociale për M. (Xh.) I.

Pas leximit të provave, Prokurori i shtetit, i pandehurit, përfaqësuesi i palës së dëmtuar kanë deklaruar se nuk kanë propozime të tjera sa i përket procedurës së plotësimit të provave dhe procedura ka vazhduar me marrjen në pyetje të të pandehurit.

I pandehuri M.I në mbrojtën e tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të dt.27.05.2019 ka theksuar se unë kam qenë shfrytëzues në banesën e cila gjendet në rr. "... " E-... nr. ..., na kanë dëbuar nga banesa, i kam 3 fëmijë, gjykatës i kam prezantuar se kam qenë me ndihmë sociale, i pa punë dhe kam qenë i detyruar për strehim të familjes që të kthehem prapë, ende jam në atë banesë edhe pse janë kushtet e rënda, por gjykatën ashtu siç e kam njoftuar në fillim të këtij rasti me ndihmën e organizatave jo qeveritare është në përfundim shtëpia ime e cila do të ndërtohet në Komunën e

Pas paraqitjes së mbrojtjes nga i pandehuri nuk ka pasur propozime nga palët për plotësimin e procedurës së provave.

Pas procedimit të provave në këtë shqyrtim gjyqësor, paraqitjes së mbrojtjes nga ana e të pandehurit dhe pasi që palët nuk kanë pasur propozime për plotësimin e procedurës së provave është konstatuar e përfunduar procedura e provave, ndërsa pas vlerësimit të provave të proceduara në këtë çështje dhe të vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera gjykata në mbështetje të nenit 361 par.2 të KPP-së, ka vërtetuar këtë gjendje si në dispozitivit të aktgjykimit dhe atë duke u provuar se i pandehuri M.I ka kryer veprën penale të Heqja e apo dëmtimi i vulave zyrtare ose shenjave nga neni 414 te KPRK-se, dhe veprën penale Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.2 nën par.2.2 të KPRK-së.

Gjykata në veprimet e të pandehurit, vërtetoi se ekzistojnë elementet e veprës penale të Heqja e apo dëmtimi i vulave zyrtare ose shenjave nga neni 414 te KPRK-së dhe veprën penale Uzurpim i paligjshme i pronës se paluajtshme nga neni 332 par.2 nënpar.2.2 te KPRK-es, kjo është vërtetuar në bazë të provave të administruar gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor pasi që nuk është kontestuese për gjykatën dhe është fakt i vërtetuar se i pandehuri ka kryer veprat penale të cilat i vihen barrë në aktakuzë dhe kjo vërtetohet edhe në bazë të provave dhe atë; raporti i dëbimit i dt. 20.03.2014, raporti ditor në teren me numër të lëndës ... i dt.21.03.2014, i pandehuri vete e pohon faktin se e ka shfrytëzuar banesën ne rr. "... " E-... nr. ... dhe i njëjti pas dëbimit dhe ndalimit për shfrytëzim të mëtejme të kësaj banese është rikthyer aty, dëshmia e dëshmitari A.A. e vërteton faktin se me dt. 21.03.2014 sipas raportit rreth orës 10:40 kemi qenë në inspektim dhe kemi konstatuar se pronës i është hequr vula, i është ndërruar çelësi dhe personi i njëjtit është takuar në pronë është fjala për M.I, po ashtu dhe dëshmitari A.K., fakte të cilat nuk janë kontestuar dhe mohuar nga vet i pandehuri, foto dokumentacion nga shkresat e lëndës gjithsej dy faqe me konstatim e dt.21.03.2014, të gjitha këto vërtetojnë se në veprimet e të pandehurit janë konsumuar elementet e veprave panele që i vihen në barrë.

Provat e proceduara në këtë çështje gjykata vlerëson se janë në përputhshmëri me vendimin e marrë si në dispozitivin e këtij aktgjykimi për të pandehurin të konstatuara nga provat materiale andaj gjykata i vlerësoj edhe me rastin e marrjes së aktgjykimit në shpalljen fajtor të të pandehurit, duke sqaruar rrethanat lidhur me çështjen, duke krijuar një bindje të bazuar të gjykatës me rastin e marrjes së vendimit ku është provuar se i pandehuri ka kryer veprat penale Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose shenjave nga neni 414 të KPRK-së, dhe të veprës penale Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.3 të KPRK-së në bashkim real me pikën I të dispozitivit të aktgjykimit.

Në rastin konkret në raport me çështjen penale ndaj të pandehurin nuk ekzistojnë rrethana të cilat kishin për ta përjashtuar përgjegjësin penale të të pandehurit në këtë çështje penale.

Me rastin e caktimit të llojit të dënimit dhe matjes së lartësisë së dënimit për të pandehurin gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së, si rrethanë lehtësuese mori, shprehjen e keqardhjes, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar, prind i tre fëmijëve, mbajtës i familjes, deklarin e përfaqësuesit të palës së dëmtuar se i pandehuri nuk e ka keqpërdorur asnjëherë shfrytëzimin e banesës dhe të njëjtën e ka përdor vetëm për familje, rrethanë rënduese gjykata e vlerësoj mënyrën kryerjes së veprës penale në dëmtimin të së mirës së mbrojtur, duke vlerësuar se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i këtij dënimi i paraparë sipas nenit 41 të KPRK-së pasi që njëra nga qëllimet e dënimit është të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, në parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit dhe nga të gjitha këto ka konsideruar se dënim i shqiptuar është në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë shoqërore për veprën penale për të pandehurin.

Shpallja e aktgjykimit është bërë po të njëjtën ditë në mënyrë publike në mungesë të palëve.

I pandehuri është liruar nga pagesa mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në kuptim të nenit 453 par.3 të KPP-së, duke vlerësuar rrethanat që ndërlidhen me të pandehurin, shfrytëzues i asistencës sociale, gjendjen e dobët materiale dhe se pagesa e këtyre shpenzimeve do të rrezikonte gjendjen materiale të të pandehurit, ndërsa udhëzimi i palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil-juridik u mbështet në nenin 463 të KPP-së.

Nga theksimet e theksuara si me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i përgjithshëm
P.nr.136/2014, dt.06.06.2019

Procesmbajtësja
Valdete Sadiku

Gjyqtari
Bekim Veliqi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh prej ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi, përmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.